



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 2004 / 7

PËR ODËN EKONOMIKE TË KOSOVËS

Kuvendi i Kosovës,

Duke marrë parasysh Rregulloren e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, nr. 1999/1, të 25 korrikut 1999, të ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 të 12 dhjetorit 1999, të ndryshuar mbi ligjin në fuqi në Kosovë, Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2001/9 të 15 majit 2001, “mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë”, veçanërisht Kreu 5.1(a), 5.7, 9.1.1, 9.1.26 (a), 9.3.3 dhe Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2001/19, të 13 shtatorit 2001, mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, veçanërisht nenet 1.6;

Me qëllim të koordinimit dhe të realizimit të synimeve dhe të interesave të përbashkëta në përparimin e veprimtarisë afariste të anëtarëve dhe zhvillimit më të përshpejtuar harmonik të vendit

Miraton :

LIGJIN PËR ODËN EKONOMIKE TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Ligj rregullohet themelimi, anëtarësia, selia, statusi, qëllimi, organet mjetet për punë, ndërprerja e punës, roli dhe fushëveprimi i Odës Ekonomike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm ”OEK”-ja).

Neni 2

2.1. Në OEK në pajtim më këtë ligj anëtarësimi i personave fizik dhe juridik që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Kosovë apo që kanë selinë e vet në Kosovë është vullnetar. Në OEK mund të bashkohen edhe organizata tjera të subjekteve ekonomike dhe organizatat në lëmine e shkencës, shoqatat profesionale dhe shoqatat tjera të cilat me aktivitetin e vet e përparojnë afarizmin e subjekteve ekonomike.

2.2. Anëtarësimi në OEK rrjedhë nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Neni 3

OEK-ja është organizatë profesionale jofitimprurëse dhe subjekt juridik i pavarur. Selia e OEK-së është në Prishtinë.

Neni 4

OEK-ja përfaqëson interesat e bizneseve të bashkuar në të, në raport me të gjitha subjektet e organizuara në shoqëri, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në dialogun social, ushtron dhe kryen edhe shërbime konsultuese e profesionale për anëtarësinë e vetë, me qëllim të arritjes së përparimit të veprimtarisë afariste të anëtarëve dhe harmonizimin e interesave të tyre.

Neni 5

OEK-ja me qëllim të përfaqësimit të interesave të subjekteve të anëtarësuar në të, bën elaborimin dhe analizimin e ecurive ekonomike, si dhe merr iniciativa për ndryshime dhe plotësime në sistemin ekonomik e financiar, si dhe për nxjerrjen e ligjeve të reja me qëllim të arritjes së objektivave të zhvillimit më të përshpejtuar dhe harmonik të vendit e në interes të anëtarëve të OEK-së.

Neni 6

OEK-ja punon në drejtim të lidhmërisë së ekonomisë së vendit me ekonominë e vendeve të rajonit dhe më gjërë, si dhe prezantimin e interesave të anëtarëve të saj në këto rajone me forma të ndryshme të veprimit të përcaktuar me ligj dhe me kontratë (marrëveshje).

Neni 7

Anëtarët e anëtarësuar në OEK kanë të drejta, përgjegjësi dhe obligime të barabarta në pajtim me ligjin dhe statutin e OEK.

Neni 8

8.1. Detyrat kryesore të OEK-së për realizimin e qëllimeve të saj janë:

- a). Përfaqësimi i interesave të harmonizuara të anëtarësisë në tërësi me iniciativa të reja;
- b). Bashkëpunimi me organet e pushtetit në formulimin e strategjisë së zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, zhvillimit rajonal, struktural dhe politikës adekuate industriale, përmirësimin e infrastrukturës ekonomike dhe në lëmin e politikës ekonomike mbrojtëse;
- c). Pjesëmarrja në dialogun ekonomik dhe social bashkë me asociacionet e tjera afariste, shoqatat e interesit, sindikatat etj;
- d). Zhvillimi dhe kryerja e shërbimeve të sistemit integral të afarizmit dhe të informacionit lidhur me bazat e të dhënave vendase dhe të jashtme, sidomos në lëmin e kërkesës dhe ofertës të formave të ndryshme të bashkëpunimit ekonomik dhe karakteristikave ekonomike të përgjithshme e të veçanta të tregut të Kosovës dhe vendeve të jashtme;
- e). Promovimi i tregtisë së jashtme me anë të organizimit të kontakteve afariste në mes të partnerëve vendas dhe të atyre të huaj, paraqitjes së përbashkët në panaire, prezantimit të bizneseve, delegacioneve tregtare të brendshme dhe të jashtme, me marrjen e propozimeve për investime të përbashkëta, të kompanive etj;
- f). Pjesëmarrja në procesin permanent të inovacioneve dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve, e të shërbimeve dhe në promovimin e standardeve teknike evropiane për ambientin dhe programet ekologjike;

- g). Dhënia e këshillave për zhvillim, veçanërisht lidhur me kriteret për fitimin e boniteteve financiare, mjeteve nga buxheti dhe burimet e tjera, në përgatitjen e programeve investive në biznes dhe konsultimet rreth ristrukturimit dhe rinovimit të bizneseve;
- h). Ndihma profesionale dhe konsultimet rreth zgjidhjes së çështjeve të afarizmit vijues siç është sigurimi i mjeteve qarkulluese, përdorimi racional i energjisë, racionalizimi i shpenzimeve të xhiros, furnizimi me lëndë të parë, mënjanimi i pengesave afariste, ndihma për hartimin e programeve të ristrukturimit dhe të zhvillimit të kompanive të caktuara;
- i). Ndihma për hartimin e programeve të zhvillimit dhe të investimeve, sidomos për bizneset e vogla dhe të mesme;
- j). Ndihmon ndërmarrjet në kërkesat për dhënien e dokumenteve tregtare, sidomos certifikatave për origjinën e mallit, dhe dokumenteve të tjera, në përputhje me ligjet në fuqi;
- k). Angazhimi për zgjidhjen e kontesteve ekonomike përmes arbitrazhit të përhershëm;
- l). Bashkëpunimi me institucionet e tjera në përcaktimin e nevojave për trajnime profesionale për komunitetin e biznesit si dhe trajnimeve të vazhdueshme për subjektet e anëtarësuara në Odë;
- m). Pjesëmarrja në sistemin permanent në trajnimet e të punësuarve bëhet në harmoni e me statutin dhe dispozitat tjera të veçanta të odës.

8.2. Shërbimet e përcaktuara në nenin 8 (j) dhe (k) mund të ofrohen edhe nga shoqatat tjera.

Neni 9

OEK-ja bashkëpunon me odat ekonomike jashtë dhe me organizatat e me shoqatat e huaja ekonomike.

Neni 10

10.1. Puna e OEK-së është publike. Mënyra e informimit të opinionit publik përcaktohet në Statutin e OEK-së.

10.2. Organizimi, veprimi dhe financimi duhet bërë me transparencë dhe në pajtim me Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare.

II. ORGANET DHE STRUKTURA INFORMATIVE

Neni 11

11.1. Anëtarët e OEK-së organizohen, varësisht nga veprimtaria e tyre kryesore, sipas parimit degësor në shoqatat e degëve, kurse varësisht nga selia, në njësi rajonale.

11.2. Shoqatat e degëve dhe njësitë rajonale janë forma të decentralizuara të punës, të organizimit të brendshëm dhe të procesit të marrjes së vendimeve në OEK.

11.3. Shoqatat e degëve dhe njësitë rajonale janë trupa zgjedhorë për zgjedhjen e këshillave të tyre dhe të përfaqësuesve të vet në Kuvendin e Odës.

11.4. Organet e qeverisjes së OEK-së janë:

- Kuvendi,
- Këshilli drejtues
- Kryetari
- Këshilli mbikëqyrës.

Neni 12

Kuvendi i OEK-së përbëhet nga përfaqësuesit e anëtarëve në pajtim me rregullat për procedurën e zgjedhjeve, që janë përcaktuar në këtë ligj dhe në Statutin e OEK-së.

Neni 13

Parimet themelore të zgjedhjes së këshillave të shoqatave të degëve dhe njërive rajonale, si edhe të përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e OEK-së janë këto:

1. Secili anëtar ka të drejtë aktive dhe pasive të zgjedhjes;
2. Të paktën dhjetë anëtarë të organizuar në shoqatat e degëve dhe në njësitë rajonale mund të propozojnë listën e kandidatëve për zgjedhjen e përfaqësuesve në Kuvend;
3. Numri i vendeve përfaqësuese në Kuvend për përfaqësuesit e shoqatës së caktuar të degës dhe të njërive rajonale përcaktohet në përputhje me statutin në atë mënyrë që përbërja e Kuvendit të pasqyrojë strukturën proporcionale ekonomike të degëve dhe të rajoneve, duke marrë parasysh edhe madhësinë e biznesit ekonomik, posaçërisht përfaqësimin e bizneseve të vogla dhe atyre të mesme;
4. Secili anëtar i OEK-së ka një votë dhe një numër të caktuar votash shtesë në përpjesëtim me strukturën e kapitalit dhe me numrin e punonjësve;

Neni 14

14.1. Në Kuvend do të zgjidhen kandidatët që marrin më shumë vota.

14.2. Anëtarë të Kuvendit mund të zgjidhen edhe përfaqësuesit e anëtarëve kolektivë, dhe zgjedhja e këtyre anëtarëve behet në pajtim me procedurën e zgjedhjes.

Neni 15

15.1 Anëtarët e Kuvendit e të Këshillit drejtues të Odës Ekonomike zgjidhen me mandate katër vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat. Ky mandat vlen për të gjithë personat e zgjedhur nga Kuvendi i Odës.

15.2 Personat që zgjedhën, apo që emërohen në Odë, nuk mund të jenë ata ndaj të cilëve është duke u zhvilluar procedura për vepër penale, apo të cilët kanë qenë të dënuar për vepër penale, apo për ndonjë vepër të kriminalitetit ekonomik.

15.3 Kriteret më të hollësishme do të përcaktohen me statut, ku në mes të tjerash, do të sigurohet që të gjitha kategoritë profesionale të jenë përfaqësuar në mënyrë të duhur, dhe që asnjë kategori e vetme nuk do të mbajë pozitë dominante.

15.4. OEK-u periodikisht publikon raporte lidhur me veprimtarinë e saj, së paku një herë në gjashtë muaj.

Neni 16

Dispozita më të hollësishme për procedurën e zgjedhjes do të përcaktohen me Statutin e OEK-së.

Neni 17

Kuvendi i OEK-së ka këto kompetenca:

- a). Miraton Statutin e OEK-së, ndryshimet dhe plotësimet e tij;
- b). Zgjedh Kryetarin e OEK-së;
- c). Zgjedh Këshillin drejtues të OEK-së;
- d). Zgjedh sekretarin e përgjithshëm të OEK;
- e). Harton dhe miraton programin afatmesëm dhe afatgjatë të punës, programin financiar dhe raportet për realizimin e tyre;
- f). Përcakton përqindjen e kuotës së anëtarësisë dhe vendos për shpërndarjen e mjeteve financiare për nevojat e punës të OEK-së në nivel qendror, si dhe në shkallë shoqatash të degëve dhe njësisish rajonale;
- g). Emëron kryetarin dhe arbitrit e arbitrazhit të përhershëm, dhe gjykatësit e Gjykatës së Nderit;
- h). Aprovon rregullat për punën e arbitrazhit të përhershëm dhe të Gjykatës së Nderit;
- i). Vendos për çështje të tjera në pajtim me Ligjin dhe Statutin e OEK-së.

Neni 18

Këshilli drejtues i OEK-së ka këto kompetenca:

- a). Shqyrton dhe miraton projektin e materialeve dhe të vendimeve për Kuvendin e OEK-së;
- b). Merr vendime për realizimin e programeve të punës dhe zbatimin e vendimeve të tjera të Kuvendit;
- c). Emëron përfaqësuesit e Odës në institucionet, në të cilat OEK-ja delegon përfaqësuesit e saj sipas dispozitave të veçanta;
- d). Emëron këshilla të përhershme dhe këshilla të përkohshme;
- e). Miraton aktet e përgjithshme të OEK-së, të cilat nuk janë në kompetenca të Kuvendit;
- f). Vendos për hapjen e përfaqësive ekonomike në botë;
- g). Merr vendime për çështje të tjera në pajtim me Statutin e OEK-së.

Neni 19

Kryetari i OEK-së ka këto kompetenca:

- a). Drejton dhe përfaqëson OEK-në,
- b). Kryeson mbledhjet e Këshillit Drejtues të OEK-së dhe i propozon atij vendime nga kompetenca e Këshillit Drejtues;
- c). I propozon Kuvendit zgjedhjen e Këshillit Drejtues dhe propozon zgjedhjen e sekretarit të përgjithshëm;
- d). Merr vendime për çështje të menaxhimit dhe çështje rreth financave dhe organizimit të OEK-së, në pajtim me aktet e OEK-së dhe me vendimet e Kuvendit e të Këshillit Drejtues të OEK-së,
- e). Ushtron punë të tjera në përputhje me Statutin e OEK-së,
- f). Në kuadër të autorizimit që ka, Kryetari është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së OEK-së.

Neni 20

20.1. Kuvendi i OEK-së zgjedh Këshillin mbikëqyrës të OEK-së nga radhët e përfaqësuesve të anëtarëve, që nuk janë anëtarë të Kuvendit, përkatësisht të Këshillit Drejtues të OEK-së.

20.2. Këshilli mbikëqyrës kontrollon veprimtarinë financiare dhe materiale të OEK-së.

Neni 21

21.1. Shoqatat e degëve, duke ua përshtatur shërbimet nevojave specifike të degëve të veçanta ekonomike, kontribuojnë në zhvillimin e degës, përparimin e punës dhe aktivitetit ekonomik të anëtarëve dhe në këtë mënyrë ndihmojnë aftësinë konkurruese të tyre në tregjet e brendshme dhe ato të jashtme.

21.2. Detyrat e shoqatave të degëve dhe të organeve të tyre rregullohen më hollësisht në Statutin e OEK-së.

Neni 22

22.1. Njësitë rajonale, duke ua përshtatur shërbimet e veta nevojave specifike të territoreve dhe të rajoneve të veçanta, kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të rajoneve dhe kryejnë shërbime të sistemit tërësor të njësive rajonale, sidomos për bizneset e vogla dhe ato të mesme drejtpërdrejt ose duke angazhuar seksione të veçanta profesionale në nivel qendror.

22.2. Detyrat e njësive rajonale dhe të organeve të tyre përcaktohen më saktësisht në Statutin e OEK-së.

Neni 23

Krahas formave parësore të organizimit brenda OEK-së, sipas kësaj pjese anëtarët, për të shprehur interesat e ndryshme, mund të organizohen në një apo më shumë grupe degësh të specializuara dhe shoqatash të interesit në pajtim me Statutin e Odës.

III. STATUTI I OEK-së

Neni 24

Statuti i OEK-së rregullon më saktësisht çështjet lidhur me detyrat e OEK-së në nivel qendror, degësor dhe rajonal, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë, organet e OEK-së dhe kompetencat e tyre, përbërjen dhe mënyrën e marrjes së vendimeve të organeve të OEK-së, themelimin dhe punën e shoqatave të degëve, njësive rajonale dhe formave të tjera të punës dhe organet e tjera, bashkëpunimin me odat, organizatat dhe asociacionet e tjera, Arbitrazhin e përhershëm dhe Gjykatën e Nderit, aktet e përgjithshme, karakterin publik të punës, sekretarin e përgjithshëm, shërbimin profesional, veprimtarinë financiare dhe procedurën e zgjedhjeve.

IV. GJYKATA E NDERIT DHE ARBITRAZHI I PËRHERSHËM

Neni 25

25.1. OEK-ja ka Gjykatën e Nderit. Gjykata e Nderit kujdeset për zhvillimin, realizimin dhe ruajtjen e zakoneve të mira afariste.

25.2. Gjykata e Nderit vendos:

- a). Për shkeljet e Statutit, dokumenteve të tjera dhe vendimeve të organeve të Odës në pajtim me Statutin e Odës.

25.3. Gjykata e Nderit shqipton dënime jo-monetare, masa disiplinore, përcakton përgjegjësinë dhe nxjerr vendime për to në pajtim me statutin.

Neni 26

OEK-ja ka Arbitrazhin e përherëshëm kompetent për zgjidhjen e kontesteve të biznesit në mes anëtarëve të OE-së dhe në mes anëtarëve dhe personave të tjerë juridik ose fizikë.

Neni 27

Përbërja, organizimi, kompetencat dhe procedura e Gjykatës së Nderit dhe e Arbitrazhit të Përherëshëm rregullohen më hollësisht me Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Odës.

V. MJETET PËR PUNËN E OEK-së

Neni 28

28.1. Mjetet për punën e OEK-së realizohen nga kontributet e anëtarëve, arkëtimi i shërbimeve dhe nga burimet e tjera në pajtim me Statutin e OEK-së.

28.2. Shuma e kontributit të anëtarëve dhe kushtet e pagimit caktohen me vendim të Kuvendit të OEK-së në pajtim me ligjin.

28.3 Për çdo vit OEK-ja harton dhe miraton planin dhe raportin financiar.

28.4. Për realizimin e detyrave të caktuara dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta, për të cilat janë të interesuar një numër më i madh i anëtarëve të OEK-së në shoqatën e degës ose në njësinë rajonale, anëtarët mund të mbledhin mjete plotësuese dhe të krijojnë fonde të destinuara, në pajtim me Statutin e Odës.

28.5. Raportin financiar vjetor të OEK-së e kontrollon auditori i pavarur.

VI. SHËRBIMI PROFESIONAL I ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS

Neni 29

Funksionet profesionale, administrative, teknike dhe funksionet e tjera për nevoja të OEK-së i kryen Shërbimi profesional i OEK-së në pajtim me Statutin dhe me aktet e tjera të OEK-së.

Neni 30

OEK-ja ka sekretarin e përgjithshëm, i cili mund t'a përfaqësojë OEK-në në rast të mungesës së Kryetarit, me autorizimin e kryetarit, drejton dhe organizon punën e shërbimit profesional dhe kryen punë të tjera në pajtim me aktet e përgjithshëm të OEK-së.

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 31

31.1. Oda Ekonomike e Kosovës që ekziston në ditën e miratimit të këtij ligji konsiderohet si Odë që deri në organizimin e ri mund të funksionojë sipas këtij ligji.

31.2. OEK-ja është e obliguar që ti mbajë zgjedhjet, të harmonizojë organizimin, statutin, aktet e përgjithshme dhe punën e vetë me këtë ligj, jo më vonë se tre muaj pas hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Neni 32

Ndërprerja e punës së Odës mund të bëhet me ligj të veçantë.

Neni 33

Ditën kur ky ligj hyn në fuqi, shfuqizohet ligji mbi bashkimin në Odën Ekonomike të Kosovës të publikuar në Gazetën zyrtare të Kosovës nr. 41/79 dhe 20/84.

Neni 34

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 2004 / 7
20 maj 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik Nexhat Daci